

KURAJO CIVILE + PUBLIK

dy partnerë të domosdoshëm
për një shoqëri solidare

„Për të edukuar një fëmijë nevojitet një fshat“ (proverb afrikan)

Fushata „Mos shiko mënjane“ ilustron idenë se çdo anëtar i shoqërisë, në varësi të situatës dhe sipas mundësive të tyre, mund të jetë pjesë e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve nga rreziqet si dhe pjesë e ndihmës ndaj të gjithë qënieve njerëzore në gjendje emergjente.

Qytetarët dhe njerëzit në fushën e biznesit shprehin publikisht gatishmërinë e tyre për të siguruar ndihmëdhënien dhe shprehin shumë qartë qëndrimin e tyre:

„Unë nuk shikoj mënjane! - Unë marr përgjegjësi dhe tregoj kurajo civile me ndihmën time.“

Çfarë mund të bëjmë kundër dhunës në jetën e përditshme

Dhuna mund të shfaqet çdo ditë në shumë forma dhe në vende të ndryshme. Shumë njerëz reagojnë në mënyrë të pasigurtë dhe për arsye të ndryshme bëjnë sikur nuk shohin ose dëgjojnë. Si rrjedhojë gatishmëria për dhunë dhe toleranca ndaj saj mund të promovohen dhe të forcohen. Në trajtimin e dhunës, ka shumë gjetje që tregojnë se si mund të ndalohen aktet e dhunës. Këto gjetje tregojnë gjithashtu se si mund të veprojmë në mënyrë që dhuna të mos lindë në radhë të parë.

- Është gjithmonë veprimi i drejtë të telefononi numrin e emergjencës së policisë (Tel. 110) dhe të raportoni krimet në komisariatit e policisë lokale.
- Bazohuni tek aftësitë tuaja personale dhe mos e vendosni veten në rrezik. Çdo situatë është e ndryshme dhe varet nga autori i krimit, nga viktimat, nga pjesëmarrësit e tjerë dhe natyrisht nga vendi e rrethanat.
- Mos përdorni armë për mbrojtje, si për shembull thika. Të gjitha gjetjet e deritanishme tregojnë se sinjale të tilla të dërguara nga ju në drejtim të sulmuesit mund të rrisin ose të legjitimojnë zemërimin dhe dhunën e tyre. Përveç kësaj, ju nuk mund të përjashtoni mundësinë se papritur kjo armë mund të përdoret kundër jush.
- Si alternativë ka pajisje sinjalizuese, si për shembull bilbilat ose pajisje të vogla alarmuese. Kjo ju lejon të merrni vëmendje dhe të krijoni publik duke i ndaluar autorët në një moment frike. Autorët shpesh nuk guxojnë të realizojnë qëllimin e tyre kur kanë frikë se mos njihen nga dikush.


Çfarë ne mund të bëjmë!

Shumë fëmijë dhe adoleshentë e kanë të vështirë, veçanërisht në situata jashtë të zakonshmes (për shembull nën shok), të komunikojnë menjëherë në mënyrë të kuptueshme. Disa kanë frikë gjithashtu se të rriturit nuk do t'i dëgjojnë siç duhet dhe nuk do t'i marrin seriozisht frikërat ose problemet e tyre.

Prandaj merrni me patjetër seriozisht fëmijët dhe të rinjtë që kërkojnë ndihmë. Dëgjojeni mirë dhe përpuni të strukturoni dhe organizoni qartë situatën për veten tuaj. Lajmëroni pastaj ndihmën e nevojshme (për shembull: policia 110, zjarrfikësja 112).



SCHAU NICHT WEG



BEI GEWALT GEGEN KINDER UND JUGENDLICHE

Në transportin publik:

Kur dikush ngacmohet, sulmohet ose plagoset në transportin publik, shpesh bashkëudhëtarët janë të tronditur ose të frikësuar. Ata nuk dinë si të sillen.

Megjithatë, ja se çfarë mund të bëni:

- Mund t'u kërkos bashkëudhëtarëve që së bashku të tërhiqni vëmendjen ndaj situatës me zë të lartë. Është e rëndësishme që: sa më shumë bashkëudhëtarëve t'ju drejtohem drejtpërdrejt që të marrin përgjegjësi, aq më i fortë është efekti kundër sulmuesve! Zakonisht do përfshihen gjithnjë e më shumë njerëz.
- Kjo e bën situatën të pamëshueshme dhe të rrezikshme për sulmuesit. Ka shumë të ngjarë që ata të përpiqen të largohen nga vendngjarja.
- Gjithashtu mund t'i kërkos shoferit/-es të telefonojë policinë. Ti je i detyruar ta bësh këtë gjë.
- Nëse nuk mund të kontaktoni drejtpërdrejt, bërtitni me zë të lartë: "Shoferi/-ja duhet të informojë policinë!" Në varësi të gjendjes dhe situatës, ju gjithashtu mund të kërkonit të mbyllen dyert në mënyrë që autorët të mos mund të largohen derisa policia të mbërrijë.

Në zonën e këmbësorëve:

- Mos u provokoni nga situata të dhunshme! Shpesh dhuna lind sepse njëra fjalë sjell tjetrën.
- Mos iu drejtoni sulmuesit me „ti“. Kalimtarët e tjerë mund të dyshojnë lehtësisht se bëhet fjalë për një konflikt privat.
- Merrni situatën në dorë, flisni me njerëzit e tjerë të pranishëm drejtpërsëdrejti dhe personalisht: „Përsëritet, ju atje me pallton e gjelbër, ju lutem më ndihmoni, telefononi policinë menjëherë!“
- Nëse personi i adresuar reagon, zakonisht thyhet akulli dhe ndodh i ashtuquajtur i efekti i topit të borës. Tani mund të bëni pjesëmarrës edhe kalimtarë të tjerë.


Në rast të përleshjeve:

- Kur fëmijë, adoleshentë ose të rritur përleshën me njëri-tjetrin, tërhiqni vëmendjen në drejtim të situatës dhe vetes tuaj dhe krijoni publik nga një distancë e sigurtë. Telefononi policinë ose lutjuni dikujt që të kërkojë ndihmë ose policinë.
- Autorët kanë frikë se mos njihen dhe se mos mbahen përgjegjës. Prandaj nëqoftëse keni dëgjuar një emër adresoj atij drejtpërdrejt ose përmendni tipare të qarta dalluese si: „Ti me ballin e madh, ne të njohim, - ndalo... ne e kemi lajmëruar policinë tashmë ...“
- Shumë fëmijë dhe adoleshentë, kur merren në pyetje në situata të tilla, shprehin se „çdo gjë ishte thjesht vetëm lojë apo argëtim“. Por ata reflektojnë shumë shpejt, nëqoftëse ju shqiptoni me zë të lartë dhunën e saponodhur, si: „Unë po shoh një plagë të gjakosur, një sy të nxirë, pantallona të shqyera etj., kjo nuk është më për të qeshur! Kjo është një sakatosje...“
- Me një qëndrim të tillë të qartë ju udhëhiqni bisedën dhe merrni mbi vete përgjegjësinë e situatës.

! E rëndësishme: Kallëzimet penale, hetimet policore dhe proceset gjyqësore u shkaktojnë autorëve të dhunshëm shqetësime të konsiderueshme dhe vështirësi shtesë. Autorët e dhunshëm duhet të dinë se ata do të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Policia është gjatë gjithë kohës në dispozicion dhe mënyra më e shpejtë është nëpërmjet numrit të urgjencës 110.



SCHAU NICHT WEG



**BEI GEWALT GEGEN
KINDER UND JUGENDLICHE**

Nëse kërcënoheni ose sulmoheni ju vetë:

Parapërgatituni!

Parapërgatituni për situata të mundshme kërcënuese: Inskenoni situata të ndryshme vetëm ose me persona të tjerë. Jini të qartë me veten tuaj për rrezikun personal që jeni i gatshëm të ndërmerrni. Është më mirë të lajmëroni menjëherë policinë (Tel. 110) dhe të merrni ndihmë sesa të mos jeni në gjendje të vendosni pro ose kundër ndërhyrjes dhe të mos bëni asgjë fare.

Ruani qetesinë!

Shmangni panikun e ngutjen dhe mundësisht mos bëni lëvizje të nxituara të cilat mund të provokojnë reagime refleksive. Zakonisht dikush që ruan qetesinë ka një efekt qetësues edhe tek njerëzit e tjerë të përfshirë!

Bëhuni aktiv!

Është e rëndësishme të mos lejoni që frika t'ju paralizojë. Të bësh një gjest të vogël është më mirë sesa të mendosh për bëma të mëdha heroike. Nëse jeni dëshmitar i dhunës, tregoni se jeni të gatshëm të ndërhyni sipas mundësive tuaja. Një hap i vetëm, një pyetje e shkurtër, çdo veprim ndryshon situatën dhe mund të frymëzojë të tjerët të ndërhyjnë gjithashtu.

Mos lejoni të viktimizoheni nga të tjerët!

Nëse sulmoheni, mos u tregoni të nënshtruar. Jini të qartë për prioritetet tuaja dhe tregoni qartë se çfarë dëshironi. Merrni iniciativën për të kthyer situatën në favorin tuaj.

Mbani kontakt me sulmuesin!

Vendosni kontakt viziv me sulmuesin dhe përpiquni të krijoni dhe të mbani një komunikim me të.

Flisni dhe dëgjoni!

Flisni qartë, me qetësi dhe me zë të lartë. Dëgjoni mirë çfarë thotë personi tjetër përballë. Nga ajo që komunikohet mund të planifikoni hapat tuaj të ardhshëm.

Mos kërcënoni ose ofendon!

Mos bëni vërejtje nënçmuese për sulmuesin. Mundohuni të mos dukeni frikacak ose kërcënues. Kritikoni sjelljen e tij, por mos e zhvlerësoni personalisht.

Merrni ndihmë!

Mos iu drejtoni një grumbull në mënyrë anonime, por njerëzve individualisht. Kjo vlen si për viktimën ashtu edhe për kalimtarët. Kalimtarët janë më të gatshëm të ndihmojnë kur dikush tjetër hedh hapin e parë ose kur ata pyeten personalisht.

Shmangni kontaktin fizik!

Kurdoherë që i vini në ndihmë dikujt përpiquni të shmangni kontaktin fizik me sulmuesin, përndryshe ju me qetësi mund të kapni fort sulmuesin vetëm në rast se jeni diçka persona. Kontakti fizik është zakonisht një tejkallim i kufijve që mund të çojë në dhunë të mëtejshme. Në rast nevojë, kontaktoni direkt me viktimën.

